REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 944/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.944/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik N.P.T "Arta-Tex", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore", me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK LIPJAN, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore", me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK LIPJAN.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore", me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK LIPJAN, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik: "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 16.11.2020 me nr. 944/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore", me nr. të prokurimit: 613-20-5228-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– KK LIPJAN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 60, 59 dhe 108/A i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 38 dhe 39 pika 39.6 te RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 24.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Komuna e Lipjanit , gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë.
Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "IDEA EET" sh.p.k - Suharekë
Eksperti shqyrtues sqaron se AK me datë 30.10.2020 ka kërkuar nga OE ankues sqarim për tender jo normalisht të ulët. OE ankues ka dhënë përgjigjen e kërkuar nga AK me arsyetimin se ka kalkuluar një marzhë (përqindje e fitimit) me të vogël të fitimit pasi që jemi firmë e re dhe kemi nevojë që të marrim referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve në mënyrë profesionale, si dhe është në gjendje të kryej furnizimet me çmimet e dhëna si në dosjen e tenderit. AK - komisioni i vlerësimit nuk është bindur se i njëjti

ka dhënë sqarime (shpjegime) të mjaftueshme dhe ka kërkuar nga OE ankues që ti sjellin mostra për artikujt që do të furnizoj (për maska dhe dezinfektues). Me datë 05.11.2020, AK e eliminon operatorin ekonomik ankues "Idea EET" Sh.p.k. me arsyetimin se ka ofruar me çmime jo-normalisht të ulëta. OE ankues i pa kënaqur me këtë vendim, me datë 07.11.2020 parashtron kërkesë për ri-shqyrtim. Kurse, AK me datë 11.11.2020 nxjerr vendim për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim me arsyetimin:

- Oferta juaj është refuzuar sepse me çmimet që keni ofertuar nuk e keni bindur komisionin vlerësues;
- Për shkak të çmimeve të ulëta, komisioni vlerësues ka kërkuar mostrat dhe këto mostra nuk i plotësojnë kriteret e specifikave teknike të paraqitura në dosje të tenderit, ju keni ofruar maska që nuk janë as përafërsisht me karakteristikat e kërkuara;
- Dezinfektuesi me bazë të alkoolit nuk e ka përmbajtjen që është specifikuar në dosje të tenderit.

OE ankues e kundërshton këtë vendim të AK-së dhe me datë 16.11.2020 parashtron ankesë pranë OSHP-së me pretendimet e njëjta sikurse në kërkesën për ri-shqyrtim.

- Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve për këtë aktivitet të prokurimit, sqaron se arsyetimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (Idea EET) se ankesa e OE është e pa bazuar për shkak se AK me rastin e aplikimit të formulës sipas nenit 3 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët gabimisht ka aplikuar këtë rregull sepse i ka kalkuluar të gjithë tenderët (duke përfshirë edhe operatorët ekonomik të cilët i ka trajtuar si të pa përgjegjshëm). Andaj, eksperti konsideron se AK duhet që me rastin e nxjerrjes së çmimit mesatar të ofertave ti përfshijë vetëm tenderët e përgjegjshëm, duke i larguar nga kalkulimi tenderët e pa përgjegjshëm konform pikës "i" të nenit 3 të Rregullës për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, e cilat përcakton:

  i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve **të përgjegjshëm;**

- Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit nga ana e autoritetit kontraktues që ka të bëjë me maska dhe dezinfektues, eksperti shqyrtues sqaron se AK ne seksionin 2 FDT, pika 1.2 ka kërkuar:

  "Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimeshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore". Lidhur me këtë, AK publikon NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE ose PERMIRESIM I GABIMIT, si në vijim:

  1. Dezinfektues 500 ml. Përmbajtje: alkoholi minimum 65-75% vret 99.9% të bakterieve. Dezinfektuesi duhet të jetë gel dhe të ketë këtë përmbajtje Alcohol, Aqua, Glycerin, Carbopal, Parfum, Triethanolarmine. Dezinfektuesi duhet të jetë me bombolë me sperkatës.

2.Maska shumëpërdorimshe. Minimum dy shtresa të jetë nga materiali trevir me kapse për hund e përshtatshme për vendosje të mbrojë nga grimcat e imëta dhe virusi. Madhësia të jetë 175 mm x 95mm

Lidhur me këtë përmirësim të AK-së, në tenderin e OE ankues, saktësisht në paramasë është i njëjti përshkrim sikurse në informatën shtesë apo përmirësimin e gabimit të AK-së. Më poshtë është shkëputur paramsa e OE ankues:

PARAMASA
FURNIZIMI ME MJETE MBROJTËSE: MASKA DHE DEZINFEKTUES PËR TË GJITHA IEA
Kontratë kornizë një vjeqare

Nr.	Përshkrimi	Pershkrimi teknik	Njësia matëse	Sasia	Çmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	Dezinfektues 500 ml	Përmbajtje: alkoholi minimum 65-75% vret 99.9% të bakterieve Dezinfektuesi duhet të jetë gel dhe të ketë këtë përmbajtje Alcohol, Aqua, Glycerin, Carbopal, Parfum, Triethanolarmine Dezinfektuesi duhet të jetë me bombolë me sperkatës	Copë	15,000	2.00	30,000.00
2	Maska shumëpërdorimshe	Minimum dy shtresa të jetë nga materiali trevir me kapse për hund e përshtatshme për vendosje të mbrojë nga grimcat e imëta dhe virusi. Madhësia të jetë 175 mmx 95mm	Copë	42,000	0.2	8,400.00
					Totali	38,400.00

IDEA EET SH.P.K.

Ndërsa, në vendimin për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim, AK ka dhënë arsyetim gjithëpërfshirës duke mos sqaruar konkretisht pse produktet e OE ankues nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së sipas nenit 108/A të LPP-së. Pra, AK nuk ka sqaruar nëse mostra e dezinfektuesit të ofruar nga OE ankues nuk përmban ndonjërin nga elementet e përshkrimit teknik sikurse në paramasë. Po ashtu, AK edhe për maskë nuk ka sqaruar nëse mostra e dorëzuar nuk përmban përshkrimit teknik sikurse në paramasë. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK i ka kërkuar mostrat edhe pse në dosje të tenderit nuk është kërkuar, si dhe pretendon se AK ka kërkuar që mostrat të dërgohen brenda një kohe shumë të shkurtër, më pak se 6 orë. Eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se në nenin 38 të RRUOPP-së përcaktohet që kur kërkohen mostrat, ato mund të dorëzohen paraprakisht ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit dhe jo si në rastin e OE ankues që të kërkohen pas mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderit. Gjithashtu, pika 38.5 e RRUOPP-së ka përcaktuar që mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe

ato janë pjesë te testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender. Në rastin e operatorit ekonomik ankues, AK ka vepruar në kundërshtim me dosjen e tenderit sepse nuk është kërkuar në dosje që mostrat të dorëzohen. Përveç kësaj që u tha më lart, edhe neni 56, par. 3 i LPP-së ka përcaktuar që operatorët ekonomik nuk përjashtohen nga procedura në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

- Ndërsa, në lidhje me pretendimin e OE ankues se AK nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri-shqyrtim, eksperti shqyrtues sqaron se secili autoritet kontraktues është i obliguar që të pezulloj procedurën me rastin e kërkesës për rishqyrtim konform nenit 6 të Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Përfundimisht, sipas asaj që u tha si më lart, vlerësimi ynë është se për këtë procedurë të prokurimit autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar procedurat e parapara me LPP-ë, për shkak se me rastin e zbatimit të rregullave për tenderët jo normalisht të ulët ka eliminuar OE ankues në kundërshtim me këto rregulla duke i përfshirë edhe operatorët ekonomik të papërgjegjshëm. Andaj, eksperti i rekomandon autoritetit kontraktues që të bëjë kalkulimet sipas rregullave për tenderët jo normalisht të ulët dhe pas kalkulimit të konstatoj nëse ky OE ka dorëzuar tendert jo normalisht të ulët, dhe përmes procesit të ri vlerësimit ti aplikoi ne tërësi dispozitat ligjore, dhe të bëjë ekzaminimin vlerësimi dhe krahasimi e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, Eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të anulohet dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me date 26.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Departamenti i Prokurimit në Lipjan në bazë të kërkesës së Drejtorisë Arsimit, ka filluar procedurën e prokurimit për përzgjedhjen e kontraktuesit për: Furnizimi me dezinfektues'! (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore, me nr te prokurimit 613-20-5228-121. Ky tender ka qenë i publikuar në faqen e KRPP-së, respektivisht në platformën elektronike, e-prokurimi deri më datë 16/10/2020. Ofertat i kanë dorëzuar 22 Operator Ekonomik (OE) Komisioni vlerësues ka konstatuar se shumë prej operatorëve ekonomik kanë ofruar çmime jo reale me ato të tregut por edhe në krahasim me mesataren e çmimeve. Pesë (5) prej këtyre OE

me çmime më të lira, i është dërguar letër standarde për të i arsyetuar çmimet e ofruara, kurse përgjigjëje kem marr vetëm prej dy OE (Ndërmarja Tregatre Grafike "Blendi" dhe IDEA EET SH.P.K). Ne si AK, nga këta dy OE, nuk ishim të bindur (me këto çmime të ofruara se kanë mundësi të na furnizojnë me produktet e ofruara, andaj nga ta kem kërkuar të na i sjellin edhe mostrat për këto produkte.

Ndërmarja Tregtare Grafike "Blendi" ka sjellë dezinfektues alkol e jo gell siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Gjithashtu maskat kanë qenë një palëshe dhe një përdorimshe, jo dypalëshe ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. IDEA EET SH.P. ka sjell mostra gell por që në përmbajtja nuk i ka pas specifikat që kanë qenë në dosje të tenderit (Dezinfektuesi duhet të jetë gel dhe të ketë këtë përmbajtje Alcohol, Aqua, Glycerin, Carbopal, Parfum, Triethanolarmine Dezinfektuesi duhet të jetë me bombolë dhe me sperkatës). Kurse Operatori Ekonomik IDEA EET SH.P ka sjell gell me përmbajtje 70 g metanol (CAS64-17-5). Kurse specifikimet për maska kanë qenë: Maskat minimum dy shtresa, të jenë nga materiali trevir me kapse për hunde, e përshtatshme për vendosje, të mbrojë nga grimcat e imëta dhe virusi. Madhësia të jetë (175 x 95) mm. Opeartori në fjalë ka sjellë maska me madhësi (230 x 140) mm dhe të pa përshtatshme për nxënës dhe për këtë është refuzuar Oferta e këtij operatori.

Operatorit, për mostrat e dorëzuara ka qenë i njoftuar me rastin e dorëzimit të mostrave te dorëzuara se nuk i përmbushin specifikimet siç janë kërkuar në dosje të tenderit.

Sa i përket pezullimt, jemi te vetëdijshëm se kemi bërë një lëshim por kjo ka ardhë si pasojë e kushteve objektive që i kemi në drejtorie e prokurimit (dy zyrtar me smundjen Covid-19 dhe një zyrtare në pushim mjekësorë për arsye shendesore-shtatzanie) dhe nuk kemi arrite me kohë që të pezullojmë këtë procedure por e kemi pa të arsyeshëm që ti pergjigjemi operatorët në kërkesën për rishqyrtim.

Këtij dokumenti, bashkëngjisim edhe mostrat e sjellura nga OE ankues, të cilat nuk përmbushin kriteret sipas dosjes të tenderit.



2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18

Apfikoni ne duar një sasi prej 3-5 ml për t'i mbajtur të lagura <to



Apfikoni ne duar një sasi prej 3-5 ml për t'i mbajtur të lagura <to

fpërdezinfektim kirurgjik të **duarve**

Apifkoni në duar dhe parakrah një sasi prej 2x **Sml** për t'i mbejtur ts

Duhet të theksohet se të gjitha hapësirat e gi 1 .1 rinjve, cepet i

dhe palosjet e lëkurës duhet të jen të laguro | Ssisht gjat gjitte

100 ml tretësirë përmbajnë

Operatori Ekonomik, me date 25.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. **613-20-5228-1-2-ltitulli: Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore,** përmes emailit me datën 24.11.2020, kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues me numër të lëndës 944/20.

Pas analizimit të raportit vërejtëm që të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën tonë të datës 16.11.2020 me nr. 944/20, janë konstatuar si të bazuara. Gjithashtu eksperti në ekspertizë ka konstatuar që Autoritetit Kontraktues i ka bërë shkeljet e të gjitha dispozitave ligjore të cilat i kemi cekur në ankesën tone të parashtruar në OSHP.

Andaj, ne konfirmojmë që pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe i rekomandojmë Panelit Shqyrtues, që të mbaj seancën dhe pas konstatimit të shkeljeve të paraqitura në ankesën tonë, të njëjtën ta aprovon si të bazuar dhe të anulon vendimin e AK-s për dhënie të kontratës dhe lëndën ta kthej në rivlerësim si dhe ta urdhëron Autoritetin Kontraktues që të eliminon shkeljet e cekura më lartë dhe të na shpërblen me kontratë neve si operator të përgjegjshëm me çmim me të ulet.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK me datë 30.10.2020 ka kërkuar nga OE ankues sqarim për tender jo normalisht të ulët. OE ankues ka dhënë përgjigjen e kërkuar nga AK me arsyetimin se ka kalkuluar një marzhë (përqindje e fitimit) me të vogël të fitimit pasi që jemi firmë e re dhe kemi nevojë që të marrim referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve në mënyrë profesionale, si dhe është në gjendje të kryej furnizimet me çmimet e dhëna si në dosjen e tenderit. AK - komisioni i vlerësimit nuk është bindur se i njëjti ka dhënë sqarime (shpjegime) të mjaftueshme dhe ka kërkuar nga OE ankues që ti sjellin mostra për artikujt që do të furnizoj (për maska dhe dezinfektues). Me datë 05.11.2020, AK e eliminon operatorin ekonomik ankues "Idea EET" Sh.p.k. me arsyetimin se ka ofruar me çmime jo-normalisht të ulëta. OE ankues i pa kënaqur me këtë vendim, me datë 07.11.2020 parashtron kërkesë për ri-shqyrtim. Kurse, AK me datë 11.11.2020 nxjerr vendim për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim me arsyetimin:

- Oferta juaj është refuzuar sepse me çmimet që keni ofertuar nuk e keni bindur komisionin vlerësues;
- Për shkak të çmimeve të ulëta, komisioni vlerësues ka kërkuar mostrat dhe këto mostra nuk i plotësojnë kriteret e specifikave teknike të paraqitura në dosje të tenderit, ju keni ofruar maska që nuk janë as përafërsisht me karakteristikat e kërkuara;
- Dezinfektuesi me bazë të alkoolit nuk e ka përmbajtjen që është specifikuar në dosje të tenderit.

OE ankues e kundërshton këtë vendim të AK-së dhe me datë 16.11.2020 parashtron ankesë pranë OSHP-së me pretendimet e njëjta sikurse në kërkesën për ri-shqyrtim.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të dokumenteve për këtë aktivitet të prokurimit, arsyetimi i AK-së në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (Idea EET) se ankesa e OE është e pa bazuar për shkak se AK me rastin e aplikimit të formulës sipas nenit 3 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të ulët gabimisht ka aplikuar këtë rregull sepse i ka kalkuluar të gjithë tenderët (duke përfshirë edhe operatorët ekonomik të cilët i ka trajtuar si të pa përgjegjshëm). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK duhet që me rastin e nxjerrjes së çmimit mesatar të ofertave ti përfshijë vetëm tenderët e përgjegjshëm, duke i larguar nga kalkulimi tenderët e pa përgjegjshëm konform pikës "i" të nenit 3 të Rregullës për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, e cilat përcakton:

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve **të përgjegjshëm;**

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë sa i përket arsyes tjetër të eliminimit nga ana e autoritetit kontraktues që ka të bëjë me maska dhe dezinfektues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ne seksionin 2 FDT, pika 1.2 ka kërkuar: "Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimeshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore". Lidhur me këtë, AK publikon NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE ose PERMIRESIM I GABIMIT, si në vijim:

1. Dezinfektues 500 ml. Përmbajtje: alkoholi minimum 65-75% vret 99.9% të bakterieve. Dezinfektuesi duhet të jetë gel dhe të ketë këtë përmbajtje Alcohol, Aqua, Glycerin, Carbopal, Parfum, Triethanolarmine. Dezinfektuesi duhet të jetë me bombolë me sperkatës.
2. Maska shumëpërdorimshe. Minimum dy shtresa të jetë nga materiali trevir me kapse për hund e përshtatshme për vendosje të mbrojë nga grimcat e imëta dhe virusi. Madhësia të jetë 175 mmx 95mm

Lidhur me këtë përmirësim të AK-së, në tenderin e OE ankues, saktësisht në paramasë është i njëjti përshkrim sikurse në informatën shtesë apo përmirësimin e gabimit të AK-së. Ku në raportin e ekspertit është shkëputur paramsa e OE ankues:

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në vendimin për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim, AK ka dhënë arsyetim gjithëpërfshirës duke mos sqaruar konkretisht pse produktet e OE ankues nuk i plotësojnë kërkesat e AK-së sipas nenit 108/A të LPP-së. Pra, AK nuk ka sqaruar nëse mostra e dezinfektuesit të ofruar nga OE ankues nuk përmban ndonjërin nga elementet e përshkrimit teknik sikurse në paramasë. Po ashtu, AK edhe për maskë nuk ka sqaruar nëse mostra e dorëzuar nuk përmban përshkrimit teknik sikurse në paramasë. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë se AK i ka kërkuar mostrat edhe pse në dosje të tenderit nuk është kërkuar, si dhe AK ka kërkuar që mostrat të dërgohen brenda një kohe shumë të shkurtër, më pak se 6 orë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se në nenin 38 të RRUOPP-së përcaktohet që kur kërkohen mostrat, ato mund të dorëzohen paraprakisht ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit dhe jo si në rastin e OE ankues që të kërkohen pas mbylljes së afatit për dorëzimin e tenderit. Gjithashtu, pika 38.5 e RRUOPP-së ka përcaktuar që mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë te testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender. Në rastin e operatorit ekonomik ankues, AK ka vepruar në kundërshtim me dosjen e tenderit sepse

nuk është kërkuar në dosje që mostrat të dorëzohen. Përveç kësaj që u tha më lart, edhe neni 56, par. 3 i LPP-së ka përcaktuar që operatorët ekonomik nuk përjashtohen nga procedura në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë se AK nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri-shqyrtim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se secili autoritet kontraktues është i obliguar që të pezulloj procedurën me rastin e kërkesës për rishqyrtim konform nenit 6 të Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar procedurat e parapara me LPP-ë, për shkak se me rastin e zbatimit të rregullave për tenderët jo normalisht të ulët ka eliminuar OE ankues në kundërshtim me këto rregulla duke i përfshirë edhe operatorët ekonomik të papërgjegjshëm. Andaj, obligohet autoritetit kontraktues që të bëjë kalkulimet sipas rregullave për tenderët jo normalisht të ulët dhe pas kalkulimit të konstatoj nëse ky OE ka dorëzuar tender jo normalisht të ulët, dhe përmes procesit të ri vlerësimit ti aplikoi ne tërësi dispozitat ligjore, dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK LIPJAN";

1x1 OE "IDEA EET"sh.p.k –Suharekë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.